



Shkruan: Dr. Shëfqet Krasniqi

Veç sa lamë pas festen e Kurban Bajramit, të cilën i madh e i vogël e festuam, zaten, bajrami, qoftë ai i madhi apo ky i vogli, gjithmonë ka qenë diç e veçantë tek populli shqiptar, edhe në luftë edhe në paqë. Asnjëherë nuk e kanë lënë pa e festuar, dhe atë në formën më të mirë të mundshme, gjë kjo e pëlqyer shumë edhe fetarisht. Jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri bajrami u festua në mënyrën më madhështore, bile atje i kushtohet një rëndësi më e madhe sesa tek ne këtu në Kosovë. Atje gjithmonë e kanë falur bajramin jashtë xhamive diku në ambient të hapur, në natyrë. Në Tiranë p.sh. bajrami është falur në sheshin që është para parlamentit të sotëm, e që është quajtur “namazgja”, ku po kërkohet që të ndërtohet xhamia madhe. Një traditë e njëjtë është ndjekur edhe nga qytetet tjera. Siç duket, në Shqipëri bajrami më shumë është një festë gjithëpopullore sesa një festë Islame. Këtë e them ndërsa parasysht kam faktin se në faljen e namazit të bajramit, përveç atyre muslimanëve që nuk praktikojnë shumë fenë, madje edhe bëjnë mëkate të mëdha si konsumimi i alkoolit, mishit të derrit, etj, pjesë marrin dhe një numër i konsiderueshëm i jomuslimanëve, ortodoksë dhe katolikë, gjë që tek ne kjo nuk ndodhë. Mjerisht, tek ne edhe përqindja e muslimanëve në faljen e bajramit është e vogël, ani pse që të gjithë, ose pjesa dërrmuese e tyre e festojnë atë në shtëpitë e tyre. Ngurrimi i tyre mund të ketë arsyetime të ndryshme por mbase mund të jetë edhe si shkak i mosdijes për formën dhe mënyrën (shumë të thjeshtë) të faljes, gjë, që në rast të faljes në ndonjë hapësirë në natyrë nuk do ta kishin, sepse do të mund të qëndronin në ndonjë skaj dhe vetëm të përcjellin ceremoninë, ashtu siç ndodhë dhe në Shqipëri. Për këtë arsye unë që moti kërkoj nga BIRK-u që edhe tek ne në Kosovë bajrami të falet jashtë diku në hapësirë të hapur ku do të kishin pasur mundësi të vijnë shtresa të ndryshe të njerëzve, jo vetëm ata që nuk dinë të falen e që nuk janë praktikues të Islamit, por edhe gra e fëmijë, komplet familja. Por ja që ende nuk kam hasur në mirëkuptim me ta në këtë çështje, vetëm se shpresoj që në të ardhmen do të përgjigjen, sepse tek e fundit bajrami është për të gjithë dhe i gjithëve. Pastaj është edhe synet –traditë e Profetit (paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të) që bajrami të falet në natyrë të hapur e jo nëpër xhami.

Festën e kurban bajramit popullit të Kosovës ia uroj edhe presidenti amerikan Barak Obama nëpërmjet homologes së tij Atifete Jahjaga presidentes së Kosovës. Ia uroj bajramin sepse Obama e di që Atifetja dhe populli i saj janë me shumicë absolute myslimanë dhe me këtë desh

t'ia bëjë me dije se ne ju konsiderojmë si myslimanë dhe se për të tillë ju kemi ndihmuar dhe ju ndihmojmë edhe më tej. Bile me këtë zyrtarët më të lartë amerikanë sa e sa herë janë krenuar edhe para botës arabe si ish-presidenti Bush, pastaj zonja Klinton dhe të tjerë, se ne amerikanët nuk jemi kundër Islamit dhe myslimanëve sepse ne e kemi çliruar një vend me popullatë shumicë absolute myslimane. Vërtetësinë e këtij fakti nuk mund ta mohoj askush, por ja që zyrtarët kosovarë dinë ta injorojnë atë. Obama nga Uashingtoni gjen kohë dhe hapësirë për t'ia uruar Atifetes dhe popullit të saj bajramin, ndërsa vet Atifetja nuk gjen kohë për të shkuar në seli të Bashkësisë Islame për urime, ani pse selia e saj është shumë afër asaj të BIRK-ut. E nëse ajo nuk ka mundur të shkoj për ndonjë arsye, së paku ka qenë dashur që këshilltari i parë i saj ta bëjë këtë gjë, apo dikush nga zyra e saj, por si duket e tërë presidenca kanë ra dakord në këtë çështje. Ajo nuk gjen kohë as për t'ju drejtuar me një mesazh në TV popullit të saj për hir të kësaj feste të madhe.

Në anën tjetër sekretarja e shtetit amerikan zonja Klinton ia uron festen homologut të saj Enver Hoxhës, e që është edhe një dëshmi shtesë e asaj që ceka më lartë se si e konsideron Amerika popullin e Kosovës. Faleminderit president Obama, faleminderit zonja Klinton, por jo edhe presidentes Jahjaga dhe ministrit Hoxhaj. Sepse vet Enveri nga ana e tij kinse po ua uroj gjithë përfaqësuesve të ligës arabe festen e bajramit, e në realitet Enveri është ai i cili ka luftuar Islamin sa ka qenë ministër i arsimit dhe krejt kjo rrëmujë e hallakamë që është bërë për mbulesën e vajzave në shkolla fillore e të mesme është shkak i vendimit të tij për ta ndaluar mbulesën sa ishte ministër i arsimit. Andaj Enveri me këtë gjest nuk mundë ta lajë mëkatën e tij të madh që e ka bërë karshi vet popullit të tij mysliman. Zoti sheh dhe dëgjon, e ai ka për të marr hakë.

Nuk u vërejt vetëm mungesa e presidentes së vendit në urimet e bajramit, por edhe ajo e liderëve të LDK-ës, partisë më të madhe opozitare në vend. As këtë bajram, e as në të kaluarin unë nuk vëreja asnjë zyrtarë të lartë të asaj partie, në veçanti liderin e saj për të cilin kam menduar se krenohet me Islam, por si duket paskam gabuar, Zoti më faltë. Ai jo vetëm si lider i partisë, por edhe si i pari i Prishtinës që 100% votat i ka marr nga myslimanët, nuk gjen kohë për të ardhur në xhami e për ta falur bajramin bashkë me qytetarë, e as të shkoj deri në seli të BIRK-ut për tua uruar festën e bajramit. Nuk e di çka mendojnë këta njerëz, si mund t'i kërkojnë votat e myslimanëve kur kaq shumë i injorojnë?! Allahu na i drejtoftë këta udhëheqës!

Kësaj radhe atë çka kemi vërejtur dhe na ka ra në sy më shumë është edhe çështja e mediave të cilat si duket i kanë dhënë më shumë hapësirë festës së bajramit në mediumet e tyre, në veçanti RTK dhe Klan Kosova për çka edhe i falënderoj publikisht. Por duhet të bëjnë edhe më shumë, sepse këta njerëz janë myslimanë dhe se Islami është fe e tyre, është identitet i tyre, e në të ka vetëm të mira dhe dobi.